

SHQIPËRIA 2018, RAPORT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Shqipërisë është një demokraci parlamentare. Kushtetuta ia vesh autoritetin legjislativ parlamentit (Kuvendit) me një dhomë, i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri drejton qeverinë, ndërkohë që presidenti ka pushtet të kufizuar ekzekutiv. Në qershor 2017, vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) raportoi se zgjedhjet respektojnë liritë themelore, por u njollosën nga pretendime për blerje votash dhe presion mbi votuesit.

Autoritetet civile ruajtën kontroll të efektshëm mbi forcat e sigurisë.

Çështjet e të drejtave të njeriut përfshinë korrupsionin e kudogjendur në të gjitha degët e qeverisjes.

Pandëshkueshmëria mbeti problem. Ndjekja penale, dhe sidomos dënimi i zyrtarëve që kryenin abuzime ishin sporadike dhe jokonseguente. Zyrtarë, politikanë, gjyqtarë dhe persona me interesa të fuqishme biznesi shpesh ia dilnin të shmangnin ndjekjen penale. Si përgjigje, autoritetet kanë ndërmarrë një rivlerësim të monitoruar ndërkombëtarisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe kanë shkarkuar një numër domethënës zyrtarësh për pasuri të pashpjegueshme apo për lidhje me krimin e organizuar. Autoritetet po ashtu ndërmorën masa teknike, të tilla si lejimi i të paguarit elektronik të gjobave rrugore dhe përdorimin e kamerave të trupit, për të përmirësuar llogaridhënien e policisë dhe ndëshkuan disa zyrtarë të niveleve më të ulëta për abuzime.

Seksioni 1. Respekti për Integritetin e Personit, Përfshi Lirinë nga:

a. Privimi Arbitrar i Jetës dhe Vrasje të Tjera të Jashtëligjshme apo Motivuar Politikisht

Pati një raportim se qeveria apo agjentët e saj kryen një vrasje arbitrare apo të jashtëligjshme.

Në maj, një i ri rom vdiq në paraburgim në Korçë. Familja e tij pretendoi se kishte vdekur për shkak të abuzimit nga policia, duke pretenduar se kishin foto të trupit të tij që tregonte shenja të dhunës. Zyra e Avokatit të Popullit, një organ i pavarur, kushtetues që shërben si qen roje mbi qeverisjen, arriti në përfundimin se nuk

kishte prova të mjaftueshme për të ngritur padi. Megjithatë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) raportoi parregullsi në dokumentimin e incidentit dhe ofrimin e ndihmës mjekësore për të ndaluarin. Qendra Shqiptare e Rehabilitimit nga Trauma dhe Tortura (ARCT) raportoi se oficerët e policisë sipas raportimeve të përfshirë në ndalim u transferuan në poste të tjera.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje nga apo në emër të autoriteteve qeveritare.

c. Tortura dhe Trajtim Tjetër Mizor, Çnjerëzor apo Degradues apo Ndëshkimi

Ndërkohë që kushtetuta dhe ligji i ndalojnë të tilla veprime, pati raportime se policia dhe rojet e burgjeve hera-herës rrahën dhe abuzuan të dyshuarit dhe të burgosurit, zakonisht në stacione policies. Deri në Shtator, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) kishte marrë ankesa për abuzim dhe korrupsion të policisë që çuan në sanksione administrative dhe ndjekje penale. Deri në korrik, KSHH raportonte një rast dhune të pretenduar fizike në një qendër policore. Zyra e Avokatit të Popullit raportoi se shumica e rasteve të abuzimit të pretenduar fizik apo psikologjik ndodhnin gjatë arrestimit dhe marrjes në pyetje.

Në maj, Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) i Këshillit të Europës nxori një raport mbi vizitën e vet në vend në shkurt 2017. Raporti vërente se në Durrës, CPT kishte marrë raportime për keqtrajtim fizik kohët e fundit të personave të ndryshëm nga policia, veçanërisht rrahje të forta kombinuar me goditje me shkop apo shkop bejsbolli në shputat e këmbëve, çka sipas raportit “mund të konsideroheshin torturë.” Në të gjitha rastet, keqtrajtimi i pretenduar ndodhi gjatë marrjes në pyetje nga oficerë të njësisë së hetimit penal në Stacionin e Policisë Durrës, dhe përfshi një zyrtar të caktuar të lartë. Raporti i CPT vërente se autoritetet kishin filluar hetime penale dhe disiplinore për pretendimet.

Kushtet në Burgje dhe Qendra Paraburgimi

Kushtet e këqia fizike dhe mungesa e trajtimit mjekësor, sidomos për kushte të shëndetit mendor, ishin probleme serioze, si dhe mjediset e mbipoplluara dhe korrupsioni. KSHH dhe ARCT raportuan se kushtet në disa mjedise të caktuara paraburgimi ishin aq të këqia sa të përbënin trajtim çnjerëzor. Kushtet mbetën nën standarde në mjediset policore të paraburgimit jashtë Tiranës dhe qendra të tjera urbane kryesore.

Kushtet Fizike: ARCT raportoi se problemet kryesore me të cilat burgjet u përballën gjatë vitit ishin mbipopullimi, rritja e numrit të vdekjeve gjatë ndalimit, tentativat për vetëvrasje, si dhe ndryshimet e personelit. Qeveria, Zyra e Avokatit të Popullit, KSHH dhe ARCT raportuan se mbipopullimi në burgje vazhdoi. ARCT raportoi mbipopullim akut në mjediset në Elbasan, Fier (një mjedis i ri), Rrogozhinë, Lushnje, Peqin, dhe Lezhë. Mbiipopullimi ishte më keq në qendrat e paraburgimit. Në disa raste, zyrtarë të burgjeve i vendosnin të ndaluarit pa masa disiplinore në qelitë e izolimit për shkak të mungesës së hapësirave të tjera. Kushtet në burgje dhe qendra paraburgimi për gratë ishin përgjithësisht më të mira se sa ato për burrat.

Shkaku zyrtar i vdekjes për personat që vdiqën gjatë ndalimit u raportuan shkaqet natyrore; megjithatë, nuk pati raportime për hetime për verifikimin e këtyre përfundimeve. Në gjashtë nga 10 rastet e raportuara të vdekjes në sistemin penitenciar në vitin 2017, të afërmit u ankuan se autoritetet shtetërore i mbyllën çështjet menjëherë pa hetim të mëtejshëm.

Kushtet në burgje dhe qendra paraburgimi varionin thelbësisht në varësi të moshës dhe llojit të mjedisit. Zyra e Avokatit të Popullit, KSHH dhe ARCT identifikuan probleme si në strukturat e reja ashtu dhe në ato të vjetra, të tilla si lagështira në qeli, kushte të këqia higjienike, mungesa e shtrrojeve, dhe furnizim i çrregullt me ujë dhe energji elektrike. ARCT raportoi edhe se disa mjedise kishin kushte të këqia në banja, pa ujë të ngrohtë dhe insekte.

Sipas ARCT, numri i të burgosurve me probleme të shëndetit mendor u rrit gjatë vitit. Zyra e Avokatit të Popullit dhe organizatat joqeveritare (OJQ) raportuan se autoritetet i mbanin të burgosurit me paaftësi mendore në burgjet e zakonshme, ku aksesit në kujdes shëndetësor ishte tërësisht i pamjaftueshëm.

Në raportin e majit, CPT shprehu shqetësime serioze se pacientët psikiatrikë në qendrën e posaçme Zaharia për të Burgosurit e Sëmurë në Krujë dhe Spitalin e Burgut në Tiranë vazhdonin të mbaheshin në kushte të cilat në pikëpamjen e CPT, “mund të konsideroheshin lehtësisht për shumë pacientë si çnjerëzore dhe degraduese.” Raporti po ashtu vërejti se kushtet e jetesës në të dyja mjediset ishin përkeqësuar që nga vizita e mëparshme e CPT në vitin 2014. Qeveria ngriti një grup pune në mars 2017 për ta mbyllur burgun e Zaharias dhe për t’i transferuar pacientët në një mjedis tjetër.

Kushtet në mjediset e administruara nga Ministria e Brendshme, të tilla si stacione policie dhe qendra paraburgimi të përkohshëm, ishin të pamjaftueshme, përveç mjediseve rajonale në Tiranë (përveç komisariateve, të cilat janë njësi më të vogla që janë nën drejtoritë rajonale të policisë), Durrës, Gjirokastrë, Kukës, Fier, dhe Korçë. Disa mjedisë paraburgimi nuk kishin ngrohje gjatë dimrit dhe disave iu mungonin kushtet higjienike bazë, të tilla si dushe apo lavamanë. Mjediset ishin të tejmbushura, me akses të kufizuar në tualete dhe pa ajrim, dritë natyrore, apo shtretër dhe stola. Sistemet e monitorimit me kamera nuk ekzistonin ose ishin të pamjaftueshme në shumicën e stacioneve të policisë.

Të burgosurit që kryenin dënime për dënime për terrorizëm në Fushë-Krujë shpesh ishin të izoluar pa zbatuar një proces të qartë që mbikqyrte ndalimin e tyre apo një program çradikalizimi apo rehabilitimi.

Administrimi: Zyra e Avokatit të Popullit raportoi se zyrtarët e burgjeve dhe të policisë përgjithësisht bashkëpunonin për hetimet. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) mori 77 ankesa deri në korrik, ndërkohë që Zyra e Avokatit të Popullit mori 276 ankesa nga të burgosur dhe të ndaluar deri në gusht. Shumica kishin të bënin me cilësinë e kujdesit shëndetësor, mirëqenien e të burgosurve dhe mbipopullimin. Megjithatë, Zyra e Avokatit të Popullit nuk çoi ndonjë rast për ndjekje penale.

Korrupsioni vazhdoi të ishte një problem serioz në qendrat e paraburgimit, sidomos në lidhje me aksesin në programe pune dhe lejeje të posaçme. Në maj, ish-drejtori i përgjithshëm i burgjeve Artur Zoto u dënua për përfshirjen e tij në krijimin e dokumenteve false të prokurimit për kompanitë e furnizimit me ushqime. Megjithatë, në shtator, Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda e ktheu vendimin. Në korrik, ish zëvendës drejtori i përgjithshëm i burgjeve Iljaz Labi u dënua për akuza të ngjashme korrupsioni dhe u dënua me tre vjet burg dhe iu ndalua mbajtja e posteve publike për pesë vjet. Gjatë vitit, një numër zyrtarësh të tjerë të lartë të burgjeve u arrestuan dhe dënuan për furnizimin e të burgosurve me drogë ose sepse kërkonin pagesa për vizitat nga familjarët.

Monitorimi i Pavarur: Qeveria lejoi grupet vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, median dhe organet ndërkombëtare të tilla si CPT për të monitoruar burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Në vitin 2017, Zyra e Avokatit të Popullit kreu inspektime të shpeshta të palajmëruara në paraburgime. Zyra e Avokatit të Popullit inspektoi dy qendra paraburgimi gjatë vitit. ARCT raportoi se qeveria favorizonte disa OJQ kundrejt disa të tjerave.

Përmirësime: DPB raportoi se deri në korrik, mbipopullimi i përgjithshëm i burgjeve kishte rënë në 3 përqind nga 4 përqind në vitin 2017. Si Zyra e Avokatit të Popullit ashtu edhe OJQ-të raportuan rritje në rastet e abuzimit fizik dhe psikologjik në burgje.

Një burg i ri financuar nga BE në Shkodër për 180 të paraburgosur dhe 600 të burgosur u hap më 3 gusht.

d. Arrestimi ose Ndalimi Arbitrar

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto ndalime.

Roli i Policisë dhe Aparatit të Sigurisë

Ministria e Brendshme mbikqyr Gardën e Republikës dhe Policinë e Shtetit, e cila përfshin Policinë e Kufirit dhe Migracionit. Policia e Shtetit është kryesisht përgjegjëse për sigurinë e brendshme. Garda e Republikës mbron zyrtarët e lartë shtetëtorë, personalitetet e huaja, si dhe prona të caktuara shtetëtorë. Ministria e Mbrojtjes mbikqyr forcat e armatosura, të cilat ndihmojnë popullsinë në raste nevojash humanitare. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) mbledh informacion, kryen veprimtari zbulimi dhe kundërzbulimi dhe varet nga kryeministri.

Amendamentet kushtetuese të miratuara në vitin 2016 kërkojnë nga qeveria që të krijojë një shërbim të ri hetimor, Byroja Kombëtare e Hetimit, për të punuar me një zyrë të posaçme prokurorie për të hetuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Ndërkohë që qeveria kishte mekanizma për të hetuar dhe ndëshkuar abuzimin dhe korrupsionin, korrupsioni i policisë mbeti problem. SHÇBA mori 3,832 ankesa me telefon nëpërmjet “linjës së gjelbër” anti-korrupsion deri në gusht dhe 6,439 ankesa me telefon deri në vitin 2017. Shërbimi mori edhe 1,217 ankesa me shkrim deri në gusht dhe 1,048 në vitin 2017. Shumica e ankesave pretendonin mosveprim, veprim arbitrar, abuzim detyre, apo shkelje të procedurave standarde. Deri në gusht, SHÇBA kishte paraqitur 77 shkelje administrative duke rekomanduar 133 oficerë policie për procedim disiplinor dhe gjashtë raste për ndjekje penale. Zyra e Avokatit të Popullit po ashtu trajtoi ankesa kundër oficerëve të policisë, kryesisht në lidhje me probleme me arrestime dhe ndalime.

Autoritetet civile përgjithësisht mbajtën kontroll të efektshëm mbi policinë, Gardën e Republikës, forcat e armatosura dhe SHISH, edhe pse zyrtarët në mënyrë

periodike përdorën burimet shtetërore për përfitim personal dhe anëtarë të forcave të sigurisë kryen abuzime.

Policia nuk e zbatoi ligjin gjithmonë në mënyrë të barabartë. Lidhjet personale, lidhjet politike apo kriminale, infrastruktura e dobët, mugesia e pajisjeve si dhe mbikqyrja e pamjaftueshme shpesh ndikuan zbatimin e ligjit. Udhëheqësia e dobët kontribuoi në korrupsionin dhe sjelljen joprofesionale të vazhduar. Autoritetet vazhduan të bënin përpjekje për t'i trajtuar këto probleme duke rinovuar mjediset policore, duke përditësuar automjetet dhe duke theksuar publikisht masat antikorrupsion. Ministria e Brendshme ka ngritur një sistem rivlerësimi të oficerëve të sigurisë, por Kuvendi nuk ka caktuar fonde për ta mbështetur atë.

Pandëshkueshmëria mbeti një problem serioz, edhe pse qeveria bëri përpjekje më të mëdha për ta trajtuar atë, sidomos duke rritur përdorimin e provave nga kamerat për të dokumentuar dhe ndjekur penalisht shkeljet e policisë.

Procedurat e Arrestimit dhe Trajtimi i të Ndaluarve

Ligji kërkon që, përveç arrestimeve të kryera gjatë kryerjes së një krimi, policia arreston një të dyshuar bazuar në arsye penale me një mandate të nxjerrë nga gjykatësi dhe bazuar në prova të mjaftueshme. Nuk pati raportime për arrestime sekrete. Me ligj, policia duhet të informojë menjëherë prokurorin për një arrestim. Prokurori mund ta lirojë të dyshuarin ose t'i drejtohet gjykatës brenda 48 orësh për ta mbajtur individin më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orësh për ta vendosur individin në paraburgim, lirim me kusht, t'i ndaljë udhëtimin, apo t'i kërkojë të paraqitet rregullisht në polici. Prokurorët kërkuan dhe gjykatat urdhëruan ndalimin në shumë raste penale, edhe pse gjykatat hera-herës ua mohuan prokurorëve kërkesat për ndalim të të pandehurve me lidhje të forta dhe profil të lartë.

Me ligj, policia duhet t'i transferojë të ndaluarit nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka mjedise për ndalim përtej 10 orëve. Për shkak të mbipopullimit në systemin e burgjeve, të ndaluarit, përfshi minorenët, zakonisht mbeteshin në qendra paraburgimi përtej maksimumit të mandatuar prej 10 orësh.

Pati një rast të raportuar kur policia dështoi t'i sillte të dyshuarit përpara gjykatësit brenda afatit. Më 31 mars, policia e Kukësit arrestoi 23 protestues (dhe shpalli në kërim 30 të tjerë) për djegien e kabinave të pagesës në rrugën kombëtare Durrës-Kukës. Policia i solli të ndaluarit në gjykatë më shumë se 48 orë pas arrestimit. Zyra e Avokatit të Popullit e kritikoi policinë për regjistrimin e kohës kur kishte

përpunuar protestuesit në vend të kohës së arrestimit. Zyra e Avokatit të Popullit rekomandoi që prokuroria e përgjithshme të merrte masa administrative ndaj prokurorëve të çështjes.

Kushtetuta iu kërkon autoriteteve që të informojnë personat e ndaluar menjëherë për të drejtat e tyre dhe akuzat ndaj tyre. Autoritetet ligjzbatuese nuk e respektuan gjithmonë këtë kërkesë. Ligji siguron lirin me kusht dhe ka një sistem në punë; shpesh policia liron të ndaluarit pa garanci, me kusht që të paraqiten rregullisht në stacionin e policisë. Gjykatat shpesh urdhëruan të dyshuarit që të paraqiteshin tek policia apo prokuroria çdo javë. Ndërkohë që ligji iu jep të ndaluarve të drejtën për akses të menjëhershëm tek një avokat, me shpenzime publike nëse ka nevojë, OJQ-të raportuan se marrja në pyetje shpesh ndodhte pa praninë e një avokati. Autoritetet vendosën shumë të dyshuar në arrest shtëpie, shpesh me kërkesën e tyre, sepse, nëse dënoheshin, iu llogaritet koha e qëndruar në arrest.

Arrestimi Arbitrar: Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar. Edhe pse qeveria përgjithësisht i respektoi këto ndalime, pati raste kur policia ndaloi persona për t'i marrë në pyetje për periudha të çrregullta kohe pa i arrestuar ata formalisht.

Ndalimi në Paraburgim: Ndërkohë që ligji kërkon kryerjen e shumicës së hetimeve para gjyqit brenda tre muajsh, prokurori mund ta zgjasë këtë periudhë. Ligji mundëson që ndalimi në paraburgim të mos kalojë tre vjet. Ndalimi i zgjatur në paraburgim shpesh ndodhte për shkak të hetimeve të vonuara, gabimeve të mbrojtjes, apo dështimit të qëllimshëm të avokatit mbrojtës për t'u paraqitur. Ligji mundëson gjyqtarët që t'u kërkojnë llogari avokatëve mbrojtës për mosrespektim të gjykatës. Burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, menaxhimi i dobët i kalendarit të gjykatave, personeli i pamjaftueshëm, si dhe dështimi i avokatëve dhe dëshmitarëve për t'u paraqitur nuk e la systemin e gjykatave të gjykonte çështjet në kohë. Deri në korrik, 39.4 përqind e popullsisë së burgjeve dhe paraburgimeve ishin në ndalim paraburgimi.

e. Mohimi i Gjyqit të Drejtë Publik

Edhe pse kushtetuta siguron një gjyqësor të pavarur, presioni politik, kanosja, korrupsioni i gjithëpërhapur, si dhe burimet e kufizuara, shpesh nuk e lejuan gjyqësorin të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe eficiente. Seancat e gjykatave shpesh nuk ishin të hapura për publikun. Oficerët e sigurisë në gjykata shpesh nuk lejonin vëzhgues në seanca dhe në mënyrë rutinë i telefononin gjyqtarit drejtues për të marrë leje nëse të lejonin një individ që dëshironte të merrte pjesë në një

seancë të caktuar. Disa agjenci demonstruan sjellje që injoronte urdhrat e gjykatave.

Qeveria zbatoi një proces të monitoruar ndërkombëtarisht për të vlerësuar gjyqtarët dhe për të shkarkuar ata që kishin pasuri të pashpjeguar apo lidhje me krimin e organizuar. Deri në gusht, 44 përqind e gjyqtarëve dhe prokurorëve që i ishin nënshtruar rivlerësimit kishin dështuar dhe ishin shkarkuar. Si pasojë, vetëm dy nga nëntë gjyqtarë mbeteshin në Gjykatën Kushtetuese; të tjerët ishin shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit ose kishin dhënë dorëheqjen përpara se t'i nënshtroheshin rivlerësimit, çka e la gjykatën pa kuorum. Deri në gusht, 15 nga 19 vendet në Gjykatën e Lartë po ashtu ishin bosh dhe gjykata përballej me një numër të konsiderueshëm dosjesh të prapambetura. Politizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese kërcënonte të minonte pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve.

Ministria e Drejtësisë përgjithësisht nuk ndiqte energjikisht masat disiplinore ndaj gjyqtarëve. Kur e bënte këtë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) hezitonte të miratonte masat. Deri në gusht, Ministria e Drejtësisë kishte filluar procedim disiplinor kundër katër gjyqtarëve. KLD refuzoi kërkesën për t'i shkarkuar dhe nxori një qortim publik për një prej tyre. KLD urdhëroi pezullimin e katër gjyqtarëve të gjykatës së apelit pas hetimeve për korrupsion. Njëri ishte arrestuar pasi një kërkim në shtëpinë e tij zbuloi para të thata në monedha të ndryshme me vlerë 250,000 Euro (288,000 dollarë). Gjyqi i tij vazhdonte deri në fund të vitit, edhe pse i pranonte provat kundër tij, çka do të çonte në lehtësim të dënimit. Një rast i dytë përfshinte gjyqtarë të apelit që kishin pranuar udhëtime të kushtueshme në ndeshje futbolli në Europën Perëndimore prej palëve ndërgjyqësore. Gjyqtarët e akuzuar kishin ndryshuar avokatët shpesh për të vonuar fillimin e gjyqit.

Procedurat e Gjyqeve

Kushtetuta dhe ligji mundësojnë gjyq të drejtë dhe publik. Ligji i prezumon të pandehurit të pafajshëm deri sa të dënohen. Mundëson që të pandehurit të informohen menjëherë dhe me hollësi për akuzat ndaj tyre, me përkthim falas sipas nevojës, si dhe kryerjen e një gjyqi të drejtë dhe publik pa vonesë. Të pandehurit kanë të drejtë të jenë të pranishëm në gjyqin e tyre, të konsultohen me një avokat, dhe t'iu caktohet një i tillë me shpenzime publike nëse nuk e përballojnë dot një të tillë. Ligji iu mundëson të pandehurve kohë dhe mjedise për t'u përgatitur për mbrojtje dhe akses në përkthim falas. Të pandehurit kanë të drejtën të përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë dhe prova në mbrojtje të vetes. Të pandehurit nuk mund të detyrohen të dëshmojnë apo të pranojnë fajësi.

Kanë të drejtën e apelimit. Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta, edhe pse gjyqet nuk ishin gjithmonë publike dhe aksesin në një avokat hera-herës ishte problematik. Për të mbrojtur të drejtat e të pandehurve dhe aksesin e tyre në provat kundër tyre, prokurori duhet të aplikojë tek një gjyqtar seance dëgjimore paraprahe dhe të paraqesë kërkesë për ta çuar çështjen në gjykatë.

Të Burgosur dhe të Ndaluar Politikë

Nuk pati raportime për të burgosur apo të ndaluar politikë.

Procedurat dhe Korrigjimet Gjyqësore Civile

Ndërkohë që individët dhe organizatat mund të kërkojnë korrigjime civile për shkelje të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin të ndikueshme nga korrupsioni, inefficienca, kanosja dhe ndërhyrja politike. Gjyqtarët i kryenin shumë seanca dëgjimore në zyrat e tyre, duke demonstruar mungesë transparence dhe profesionalizmi dhe duke ofruar mundësi për korrupsion. Këta faktorë minuan autoritetin e gjyqësorit, kontribuan në vendime të debatueshme gjykatash, si dhe çuan në aplikimin jokonseguent të së drejtës civile. Pavarësisht të drejtës statutores për ndihmë ligjore falas në çështje civile, OJQ-të raportuan se shumë pak individë përfituan prej saj gjatë vitit.

Personat që kishin shfrytëzuar mundësitë korrigjuese në gjykatat e vendit mund t'i drejtoheshin Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Në shumë raste, autoritetet nuk i vunë në zbatim vendimet e GJEDNJ, sidomos ato që lidheshin me të drejtën për një gjyq të drejtë.

Personat që kishin qenë të burgosur politikë gjatë regjimit të mëparshëm komunist vazhduan t'i drejtoheshin qeverisë për kompensim. Qeveria bëri njëfarë përparimi në disbursimin e kompensimit gjatë vitit.

Kthimi i Pronave

Zyra e Avokatit të Popullit dhe OJQ-të raportuan se disa pretendus vazhdojnë të luftojnë për të siguruar proces të drejtë nga qeveria për pretendimet për pronat. Mijëra pretendime për prona private dhe fetare të konfiskuar gjatë regjimit komunist mbeteshin të pazgjidhura pranë Agjencisë për Trajtimin e Pronave. Pretenduesit mund t'i drejtohen GJEDNJ; shumë raste presin të shqyrtohen nga GJEDNJ. Zyra e Avokatit të Popullit raportoi se deri në gusht, GJEDNJ kishte gjykuar shtatë çështje që kishin të bënin me miliona euro pretendime. Zyra e

Avokatit të Popullit përsëriti se qeveria, përgjithësisht, pagoi sipas afateve të përcaktuara nga GJEDNJ.

Vendi përqafoi Deklaratën Terezin në 2009 dhe Udhëzimet e Praktikave më të Mira në vitin 2010. Nuk ka ndonjë ligj për kthim apo kompensim lidhur me konfiskime të pronës private që lidhen me epokën e holokaustit. Sipas ligjit, bashkësitë fetare kanë të njëjtat të drejta kthimi dhe kompensimi si personat fizikë apo juridikë. Qeveria nuk raportoi ndonjë pretendim prone që të ketë qenë paraqitur nga viktimat të holokaustit.

f. Ndërhyrje Arbitrare apo e Jashtëligjshme në Privatësi, Familje, Shtëpi, apo Korrespondencë

Kushtetuta dhe ligjet i ndalojnë të tilla veprime, por pati raportime se qeveria dështoi t'i respektojte këto ndalime. Deri në gusht, Zyra e Avokatit të Popullit kishte marrë 30 ankesa të qytetarëve kundër Inspektoratit për Mbrojtjen e Territorit dhe nëntë kundër Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT), të cilat rregullojnë ndërtimin, zhvillimin vendor dhe burimet ujore. Zyra e Avokatit të Popullit vërejti se kishte rritje në numrin e ankesave për veprime të paligjshme, të parregullta, apo të vonuara nga inspektoratet vendore dhe kombëtar. Banorë në Shkozë u ankuan se IKMT kishte filluar të shkatërronte pronat e tyre edhe pse ata kishin filluar tashmë një proces legalizimi. Disa prej tyre kishin dokumente që tregonin tituj ligjorë mbi pronat por nuk kishin marrë kompensim kur shkatërrimi kishte filluar. Bashkësia Islamike Shqiptare mori ankesa të ngjashme nga qytetarë të inatosur për shkak të mungesës së rezultateve në marrjen e kompensimit nga procesi.

Seksioni 2. Respekti për Liritë Civile, Përfshi:

a. Lirinë e Shprehjes, Përfshi për Shtypin

Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes, përfshi për shtypin, dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta. Pati raportime se qeveria, bizneset dhe grupet kriminale u përpoqën të ndikonin median në mënyra të papërshtatshme.

Liria e Shtypit dhe Medias: Media e pavarur ishte aktive dhe shprehte shumëllojshmëri të gjerë pikëpamjesh, edhe pse pati përpjekje për të ushtruar trysni të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë politike dhe ekonomike mbi median, përfshi me anë të kërcënimeve dhe dhunës kundër gazetarëve që përpiqeshin të hetonin krimin dhe korrupsionin. Pronarët e bizneseve e përdornin median lirisht për të

siguruar favore dhe për të promovuar interesat e tyre tek partitë politike. Shumica e pronarëve të stacioneve televizive përdornin përmbajtjen e transmetimeve të tyre për të ndikuar veprimet e qeverisë ndaj bizneseve të tyre të tjera. Trysnia politike, korrupsioni, mungesa e financimeve kufizuan median e shkruar të pavarur dhe gazetarët sipas raportimeve praktikuan vetëcensurë. Pasiguria ekonomike për shkak të kontratave të zbatueshme të punës pakësonte pavarësinë e reporterëve dhe kontribuonte në anshmëri në raportime. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë vazhdoi të raportonte vonesa domethënëse në pagesën e pagave për reporterët në shumicën e organeve të medias, në disa raste deri në 10 muaj. Problemet financiare bënë që disa gazetarë të mbështeteshin më shumë tek burimet e jashtme të të ardhurave, duke çuar kështu në pikëpyetje për integritetin.

OJQ-të pohonin se etika profesionale ishte një përparësi e ulët për portalet e lajmeve në vend, të përlllogaritura në mbi 700, duke ngritur shqetësime mbi përhapjen e artikujve të lajmeve të rreme që ishin në të mirën e interesave të caktuara financiare apo politike. Rritja dramatike në organet e medias online ofronte diversitet në pikëpamje.

Në *Indeksin për Qëndrueshmërinë e Medias (MSI)*, të cilin e nxjerr çdo vit, Bordi për Kërkimet dhe Shkëmbimet Ndërkombëtare (IREX) vërejti se fjala e lirë, shumëllojshmëria e burimeve të lajmeve, si dhe institucionet mbështetëse kishin përjetuar një rritje të lehtë, por profesionalizmi dhe menaxhimi si biznes kishte rënë. Kriza ekonomike dhe praktikat e menaxhimit në mediat shqiptare kanë ulur financat dhe cilësinë e raportimit në organet mediatike. MSI vërejti se trysnia mbi financat e mediave kishte çuar në shkurtime në redaksitë e lajmeve dhe kishte përforcuar vetëcensurën.

Pavarësia e Autoritetit të Medias Audiovizive, rregullatori i tregut të medias së transmetuar, mbeti e diskutueshme dhe roli i autoritetit mbeti i kufizuar.

Dhuna dhe Ngacmimet: Pati raportime të shumta për dhunë dhe ngacmime ndaj anëtarëve të medias, dhe interesat politike dhe të biznesit i vunë gazetarët nën presion.

Më 30 gusht, një person i panjohur qëllloi 10 herë ndaj shtëpisë së prindërve të gazetares së kronikës Klodiana Lala. Nuk pati raportime për lëndime, por dy vajzat e gazetares Lala ishin në shtëpi në kohën e sulmit. Lala raportonte shpesh mbi çështje të krimit të organizuar dhe zbatimit të ligjit, përfshi reformën në drejtësi. Në një postim në Facebook pas sulmit, Lala pohoi se besonte që sulmi kishte lidhje me raportimin e saj. Policia po e hetonte sulmin.

Në shtator, kreu i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë deklaroi se 12 gazetarë kishin paraqitur kërkesa për azil në vendet anëtare të BE-së, duke përmendur kërcënime për shkak të punës së tyre.

Censura dhe Kufizimet për Përmbajtjen: Gazetarët shpesh praktikuan vetëcensurë për të shmangur dhunë dhe ngacmime dhe si përgjigje ndaj presionit nga botuesit dhe redaktorët që synonin të çonin përpara interesat e tyre politike dhe ekonomike. Një anketim i vitit 2015 nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative (BIRN) Shqipëri, organizatë që përqendrohet tek gazetaria investigative, gjeti se një numër i madh kompanish tregtare dhe reklamues të rëndësishëm ishin burime kryesore të presionit. Një studim i botuar në prill nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë citoi censurën dhe vetëcensurën si problemet kryesore për gazetarët.

Ligjet për Shpifjen/Përgojimin: Ligji lejon palët private të ngrenë padi penale dhe të kërkojnë kompensim financiar për ofendim apo botim të qëllimshëm të informacionit shpifës. OJQ-të raportuan se gjoat, të cilat mund të ishin deri në tri milionë lekë (27,800 dollarë), ishin të ekzagjeruara dhe, kombinuar me futjen e dënimit në dëshminë penale të të pandehurit, minonin lirinë e shprehjes. Në prill, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë shprehu shqetësimin se gjatë katër muajve të parë të vitit, gjyqtarë dhe politikanë kishin iniciuar 14 padi kundër gazetarëve.

Në vitin 2017, një anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Gjin Gjoni, ngriti padi për shpifje kundër dy gazetarëve të BIRN dhe dy gazetarëve të së përditshmes *Shqiptarja.com* për mbulimin prej tyre të deklaratave të tij të pasurisë, të cilat po i hetonte prokuroria. Gjoni kërkonte shtatë milionë lekë (64,800 dollarë) nga BIRN dhe katër milionë lekë (37,000 dollarë) nga *Shqiptarja.com*, duke pretenduar se artikujt kishin dëmtuar reputacionin e tij. Pas disa seancash, gjykata vendosi në mars që rrëzonte çështjen ndaj *Shqiptarja.com* sepse Gjoni dhe avokatët e tij kishin dështuar të paraqiteshin në pesë nga 11 seancat. Në qershor, gjykata rrëzoi edhe çështjen ndaj BIRN. Gjoni i apeloj të dyja vendimet dhe çështjet ishin pezull.

Liria e Internetit

Qeveria nuk kufizoi apo ndërpreu aksesin në internet dhe as nuk censuroi përmbajtjen online, dhe nuk pati raportime të besueshme se qeveria monitoronte komunikimet private online pa autorizimin e duhur ligjor.

Autoriteti për Komunikimet Elektronike dhe Postare dekretoi më 15 tetor se 44 portale internet kishin 72 orë për të marrë një numër regjistrimi biznesi dhe ta

botonin në faqet e tyre në internet për ndryshe qeveria do t'i mbyllte. Lista përfshinte një numër faqesh lajmesh investigative, përfshi BIRN. Në fund të vitit, qeveria nuk i kishte mbyllur portalet që nuk e kishin zbatuar urdhrin.

Sipas të dhënave të marsit nga Internet World Stats (statistikat botërore për internetin), afërsisht 66 përqind e popullsisë përdorte internetin.

Liria Akademike dhe Aktivitetet Kulturore

Nuk pati kufizime nga qeveria mbi lirinë akademike apo aktivitetet kulturore.

b. Liritë e Grumbullimit Paqësor dhe Shoqërimit

Kushtetuta dhe ligji sigurojnë liritë e grumbullimit paqësor dhe shoqërimit dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta.

c. Liria e Fesë

Shih *Raportin Ndërkombëtar për Lirinë Fetare* të Departamentit të Shtetit në adresën: www.state.gov/religiousfreedomreport/.

d. Liria e Lëvizjes

Kushtetuta dhe ligji sigurojnë lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimit jashtë, emigracionit dhe riatdhesimit dhe qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta.

Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për të ofruar mbrojtje dhe asistencë për refugjatët, refugjatë të rikthyer, azilkërkues, persona pa nënshtetësi, si dhe persona të tjerë të ngjashëm. Policia lejoi UHCR, Zyrën e Avokatit të Popullit, dhe OJQ-në Caritas që të monitoronte përpunimin, ndalimin dhe deportimin e disa migrantëve, sidomos në jug të Shqipërisë.

Abuzimi i Migrantëve, Refugjatëve, dhe Personave pa Shtetësi: UNHCR raportoi pak raste të kanosjes dhe hezitimit nga policia për të pranuar kërkesa për azil. UNHCR mori vetëm një raport për dhunë. E ndau raportin me qeverinë, e cila mori masa për ta trajtuar ankesën.

Autoritetet shpesh ndalonin migrantë të çrregullt që hynin në vend. Deri më 23 gusht, autoritetet kishin ndaluar afërsisht 67 migrantë, kryesisht në kufirin jugor të

vendit me Greqinë; shumica e atyre që nuk kërkuan azil u deportuan në Greqi brenda 24 orësh. Migrantët e ndaluar më në brendësi të vendit mund të kalonin disa javë në pikën e mbyllur të ndalimit të migrantëve në Karrec në pritje të deportimit. UNHCR raportoi se kushtet në qendrën në Karrec ishin të papërshtatshme, sidomos për familjet dhe fëmijët.

Deri në korrik, Ministria e Brendshme raportoi se kishte patur 2,328 azilkërkues, përfshi 184 djem dhe 105 vajza, në Qendrën Kombëtare për Azilkërkuesit në Babrru. UNHCR raportoi se në total, kishte 2,947 azilkërkues deri në gusht, mbi 50 përqind e të gjithë migrantëve që kishin kaluar në vend.

Lëvizja Brenda Vendit: Për të marrë shërbimet e qeverisë, individët që ndryshojnë vendbanimin brenda vendit duhet të transferojnë regjistrimin e tyre civil në bashkësinë e re dhe të provojnë ligjshmërinë e vendbanimit të tyre nëpërmjet zotërimit të pronës, një marrëveshjeje qeramarrje, apo faturat utilitare. Shumë persona nuk mundën të ofronin prova dhe në këtë mënyrë iu mungonte akses në shërbimet publike. Të tjerë qytetarë, sidomos romë dhe egjiptianë ballkanikë, nuk kishin regjistrim në bashkësitë ku banonin. Ligji nuk e pengon regjistrimin e tyre, por shpesh ky ishte i vështirë të plotësohej. Shumë romëve dhe egjiptianëve ballkanikë iu mungonin burimet financiare për t'u regjistruar dhe shumë prej tyre nuk kishin motivimin për ta kryer procesin.

Mbrojtja e Refugjatëve

Aksesi në Azil: Ligji siguron akordimin e azilit apo statusit të refugjatit dhe qeveria ka ngritur një sistem që iu ofron mbrojtje refugjatëve.

Pati raportime të besueshme nga OJQ-të, migrantët dhe azilkërkuesit se autoritetet nuk ndiqnin procesin e duhur për disa azilkërkues dhe se në raste të tjera, ata që kërkonin azil nuk kishin akses në sistem. UNHCR, Caritas dhe Zyra e Avokatit të Popullit ishin kritike ndaj procedurave të qeverisë për kontrollin dhe ndalimin e migrantëve. Pati raportime se policia e kufirit i kishte shtyrë migrantët të ktheheshin në Greqi.

Ligji për azilin iu kërkon autoriteteve të akordojnë apo të mohojnë azilin brenda 51 ditësh nga kërkesa fillestare e aplikantit. Sipas ligjit, azilkërkuesit nuk mund të përballen me padi penale për hyrje të paligjshme nëse kontaktojnë autoritetet brenda 10 ditësh nga mbërritja e tyre në vend. UNHCR raportoi se sistemit të azilit i mungonte monitorimi i efektshëm.

Vend i Sigurt Origjine/Tranziti: Ligji ndalon individët nga vendet e sigurta të origjinës apo tranzitit që të aplikojnë për azil apo status refugjati. Megjithatë, UNHCR raportoi se nuk ishte refuzuar ndonjë kërkesë për azil bazuar në listen e qeverisë për vendet e sigurta, e cila përfshinte Greqinë.

Punësimi: Ligji i lejon refugjatët të punojnë. Megjithatë, lëshimi i kufizuar i kartave të identitetit dhe lejeve të punës për refugjatët, nënkuptonte se më pak refugjatë kishin mundësi punësimi.

Qasja në Shërbimet Bazë: Ligji iu ofron migrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve qasje në shërbimet publike, përfshirë arsim, kujdes shëndetësor, strehim, ligjzbatim, procedura gjykatash/gjyqësore, dhe asistencë ligjore. Migrantët dhe azilkërkuesit shpesh kërkuan ndërhyrjen e UNHCR-së apo OJQ-ve lokale për t'i siguruar këto shërbime.

PERSONAT PA SHTETËSI

Qeveria nuk ka informacion të besueshëm lidhur me numrin total të personave pa shtetësi ose në rrezik pashtetësie në vend.

Në korrik, UNHCR and partneri i saj, Shoqëria Tirana për Ndihmë Ligjore, publikuan një raport i cili gjurmonte popullatën në rrezik pashtetësie në vend. Raporti identifikoi 1031 persona në rrezik pashtetësie, 97% e të cilëve ishin fëmijë. Raporti nxorri përfundimin se pjesa më e madhe e atyre që ishin në rrezik pashtetësie kishin të drejtën e nënshtetësisë, por ushtrimi i kësaj të drejte ishte i vështirë.

Shumica e personave në rrezik ishin fëmijë romë apo ballkano-egjiptianë. Rreziku i pashtetësisë vazhdoi të ekzistonte për fëmijë të paregjistruar të lindur jashtë pranë familjeve të kthyer migrante, edhe pse ligji jep mundësinë për të siguruar kombësinë.

SEKSIONI 3. Liria për të marrë pjesë në procesin politik

Kushtetuta dhe ligji iu sigurojnë qytetarëve aftësinë për të zgjedhur qeverinë e tyre në zgjedhje të lira dhe të ndershme periodike, zhvilluar me votë të fshehtë mbi bazën e të drejtës universale dhe të barabartë të votës.

Zgjedhjet dhe Pjesëmarrja Politike

Zgjedhjet e Fundit: Zgjedhjet më të fundit kombëtare parlamentare u zhvilluan në qershor të 2017-ës. Misioni vëzhgues i OSBE-së për zgjedhjet raportoi, “garuesit ishin në gjendje të bënin fushatë lirisht dhe liritë themelore u respektuan”. OSBE vërejti më tej se, “Politizimi i vazhdueshëm i organeve dhe institucioneve të lidhura me zgjedhjet si dhe pretendimet e përhapura gjerësisht për blerje votash dhe presion ndaj votuesve, e zbehën besimin publik në procesin zgjedhor”. Në lidhje me votimin në vetvete, misioni i OSBE-së vërejti se “një ditë votimi përgjithësisht të rregullt” por gjeti se “procedura të rëndësishme nuk u respektuan plotësisht në një numër të konsiderueshëm qendrash votimi të vëzhguara”.

Pjesëmarrja e Grave dhe Pakicave: Nuk ka ligj që kufizon pjesëmarrjen e grave dhe anëtarëve të pakicave në procesin politik dhe faktikisht morën pjesë. Si rezultat i zgjedhjeve të qershorit 2017, numri i anëtarëve gra në Kuvend u rrit në shifrën rekord prej 29 përqind dhe 47 përqind të ministereve femra. Ligji që rregullon zgjedhjet e Kuvendit kërkon që 30 përqind e kandidatëve të jenë femra dhe që ato të zënë 30 përqind të posteve të emëruara dhe të zgjedhura. Megjithatë, sipas raportit përfundimtar të OSBE-së për zgjedhjet, partitë më të mëdha nuk e respektuan gjithmonë kuotën e detyrueshme prej 30 përqind në listat e kandidatëve të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i gjobiti këto parti por prapëseprapë i pranoi listat e tyre.

Anëtarë të pakicave kombëtare ishin kandidatë si në partitë e pakicave ashtu dhe ato kryesore, dhe zhvillimi i fushatës si në gjuhët greke ashtu edhe maqedonase u vëzhgua si pa incidente. Megjithatë, vëzhguesit raportuan se disa pakica ishin të prekshëm nga blerja e votive. Deri në shtator, nuk kishte ministra apo anëtarë romë në kuvend.

SEKSIONI 4. Korrupsioni dhe Mungesa e Transparencës në Qeverisje

Ligji siguron ndëshkime penale për korrupsion nga zyrtarët publikë, por qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase, dhe zyrtarët shpesh u përfshinë në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Ligji ndalon individët me dënime penale që të shërbejnë si kryebashkiakë, deputetë apo në poste qeveritare ose shtetërore.

Kushtetuta parashikon që gjykatësit dhe prokurorët t’i nënshtrohen procesit të vetingut për pasuri të pashpjegueshme, lidhje me krimin e organizuar dhe aftësitë profesionale. Vetingu u krye nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe apelimet u shqyrtuan nga një dhomë apeli. Procesi u mbikëqyr nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, i cili përbëhej nga ekspertë ligjorë ndërkombëtarë nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian. Deri më 24 tetor, komisioni

shkarkoi 25 gjykatës dhe prokurorë, dhe konfirmoi 28, ndërsa 16 të tjerë dhanë dorëheqjen për të mos kaluar në procesin e vetingut.

Një numër agjencish qeveritare hetuan rastet e korrupsionit, por burimet e kufizuara, rrjedhjet hetimore, presioni real dhe i perceptuar politik, si dhe një sistem riemërimi i çrregullt penguan hetimet. Në raste selektive ku përfshiheshin aktorë ndërkombëtarë, agjencitë antikorrupsion bashkëpunuan me shoqërinë civile.

Korrupsioni: Ndërmjet janarit dhe qershorit, zyra e prokurorit të përgjithshëm regjistroi 83 hetime të reja për korrupsion. Gjatë së njëjtës periudhë, 29 persona u dënuan për korrupsion, si dhe nisën proceset gjyqësore për 28 persona të tjerë. Deri në gusht, 19,295 ankesa iu dërguan autoriteteve nëpërmjet portalit online stopkorrupsion.al, 1396 të cilave përmbanin informacion lidhur me praktika të pretenduara korruptive. Një ish Ministër i Brendshëm vazhdoi të mbetej nën hetim për lidhje me krimin e organizuar dhe abuzim me detyrën.

Ndërkohë që prokurorët bënë përparim domethënës në ndjekjen e rasteve të korrupsionit publik të nivelit të ulët, përfshi prokurorë dhe gjyqtarë të korruptuar, ndjekja penale e krimeve të nivelit të lartë mbeti e rrallë, si pasojë e frikës së hetuesve nga ndëshkimet, mungesa e përgjithshme e burimeve, dhe korrupsioni brenda vetë gjyqësorit.

Deklarimi Financiar: Ligji iu kërkon zyrtarëve publikë që të deklarojnë pasuritë e tyre pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesit (ILDKPKI), i cili monitoroi dhe verifikoi këto deklarime dhe i vuri në dispozicion të publikut. Ligji e autorizon ILDKPKI që të gjobisë zyrtarët që nuk përmbushin kërkesat për deklarimin ose t'ia referojnë ata prokurorisë.

ILDKPKI raportoi se deri në gusht, kishte referuar 31 raste të reja në prokurori, ku përfshiheshin gjashtë deputetë, një zëvendës-ministër, një kryetar bashkie, gjashtë inspektorë taksash, gjashtë zyrtarë dogane, dhe 11 zyrtarë të tjerë qeveritarë për akuza të refuzimit të deklarimit, fshehjes, apo falsifikimit të deklaratave të pasurisë, pastrim parash, falsifikim dokumentesh dhe korrupsion. Në 2017 IDLKPKI gjobiti 296 individë për mosdeklarim të pasurive apo për shkelje të ligjit mbi mbrojtjen e denoncuesve të korrupsionit.

SEKSIONI 5. QËNDRIMI QEVERTAR NË LIDHJE ME HETIMIN NDËRKOMBËTAR DHE JOQEVERITAR TË DYSHIMEVE PËR SHKELJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Grupe vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut vepruan në përgjithësi pa kufizim nga ana e qeverisë, duke hetuar dhe botuar gjetjet e tyre mbi rastet e të drejtave të njeriut. Zyrtarët qeveritarë përgjithësisht ishin bashkëpunues dhe reagues ndaj këndvështrimeve të tyre.

Organizma Qeveritare të të Drejtave Të Njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit është institucioni kryesor për promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit autorizohet nga ligji të monitorojë dhe raportojë mbi burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Kjo zyrë mund të hapë hetime bazuar në ankesa ose nën autoritetin e tij. Megjithëse Avokati i Popullit nuk kishte fuqinë të zbatonte vendimet, ai vepronte si monitorues për shkeljet e të drejtave të njeriut. Zyra e Avokatit të Popullit kishte mungesa në fonde dhe në personel.

Kuvendi ka një komision parlamentar për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, i cili shqyrton raportin vjetor të Zyrës së Avokatit të Popullit. Komisioni ishte i angazhuar dhe efikas në çështjet legislative.

SEKSIONI 6. DISKRIMINIMI, ABUZIMET SHOQËRORE DHE TRAFIKIMI I PERSONAVE

Gratë

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Përdhunimi, përfshirë përdhunimin bashkëshortor, është krim. Ndëshkimet për përdhunim dhe ngacmim varen nga mosha e viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri dënimi me burg është nga tre deri në 10 vjet. Ligji përfshin dispozita mbi sulmin seksual dhe ngacmimin seksual dhe qartëson kriminalizimin e përdhunimit bashkëshortor.

Qeveria nuk e zbatoi me efikasitet ligjin dhe zyrtarët nuk e ndoqën penalisht përdhunimin bashkëshortor. Koncepti i përdhunimit bashkëshortor nuk ishte i kuptuar drejt, dhe autoritetet shpesh nuk e konsideruan atë si krim.

Pavarësisht ligjit për mbrojtjen e viktimave, sërish pati abuzime dhe akuza për mbulime politike. Për shembull Xhisiela Maloku pretendoi se Rexhep Rraja, i dashuri i saj dhe djali i deputetit të Partisë Socialiste Rrahman Rraja, e kishte djegur dhe dhunuar në një hotem më 19 korrik. Ekspertët e provave vërtetuan prejardhjen e plagëve. Maloku më vonë pretendoi se ajo i kishte trilluar akuzat pasi ishte xhelozë por anëtarë të Partisë opozitare Demokrate, duke cituar pretendime nga ish oficeri i policisë Emiliano Nuhu, deklaruan se Rrahman Rraja kishte ushtruar presion ndaj policisë për të detyruar Malokun të tërhiqej mbrapsht. Opozita pretendoi gjithashtu se forcat policore kishin fshehur sulmin seksual të Rexhep

Rrajës ndaj Malokut. Gjykatësi i çështjes miratoi kërkesën e prokurorit për të vazhduar me procesin gjyqësor. Rexhep Rraja është në paraburgim.

Më 23 korrik, Kuvendi amendoi ligjin mbi dhunën në familje, duke shtrirë mbrojtjen për viktimat që janë në një lidhje apo bashkim civil. Amendimi krijoi një urdhër mbrotjeje që automatikisht mbron edhe fëmijët.

Dhuna në familje kundër grave vazhdoi të mbetet problem. Për shembull, në gusht të 2017, gjykatësja Fildez Kasemi u godit për vdekje nga ish bashkëshorti i saj në Shkodër, edhe pse ajo kishte kërkuar mbrojtje për shkak të abuzimeve. Deri në dhjetor, ish bashkëshorti Fadil Kasemi, ishte duke u gjykuar për vrasje.

Një raport i PNUD dhe Institutit Shtetëror të Statistikave (INSTAT) vlerëson se më shumë se 53 përqind e grave dhe vajzave në vend kishin qenë viktime të dhunës në familje gjatë vitit të kaluar dhe më shumë se 60 përqind raportuan se kishin qenë viktime në jetën e tyre. Policia shpesh nuk kishte trajnimin ose kapacitetin për të shqyrtuar si duhet rastet e dhunës në familje.

Qeveria operoi një strehë për mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe tre streha për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore, të cilat mirëpritën edhe viktimat e dhunës në familje.

Ngacmimi Seksual: Ligji ndalon ngacmimin seksual, megjithëse zyrtarët rrallë e zbatuan atë. Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi në përgjithësi shqyrtoi raste të ngacmimit seksual dhe mund të vendosë gjoba deri në 80,000 lekë (\$741) kundër individëve ose deri në 600,000 lekë (\$5,550) kundër ndërmarrjeve.

Shtrëngimi në Kontrollin të Popullsisë: Nuk pati raporte abortimi të detyruar apo sterilizim të pavullnetshëm.

Diskriminimi: Ligji garanton status të njëjtë ligjor dhe të drejta të barabarta si për gratë dhe për burrat por qeveria nuk e zbatoi ligjin me efikasitet. Gratë nuk ishin të përfaqësuara mirë në nivelet më të larta të shumë fushave. Ligji dikton pagesë të barabartë për punë të barabartë, megjithëse shumë punëdhënës privatë nuk e zbatuan plotësisht këtë dispozitë. Në shumë komunitete gratë përjetuan diskriminim social bazuar në normat tradicionale sociale që i përshkruajnë gratë si të nënshtruara ndaj burrave.

Pati raportime për diskriminim në punësim. Në një rast, një grua 55 vjeçare u ankua në maj tek Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit, duke pretenduar

se drejtori i burgit të Vlorës e kishte pushuar nga puna për shkak të moshës dhe gjinisë së saj. Komisioneri vendosi në gusht se gruaja kishte qenë objekt diskriminimi bazuar në gjini por jo në moshë, dhe rekomandoi që burgu të tërhiqte pushimin e saj nga puna dhe ta punësonte sërish. Burgu nuk e punsëoi, ndaj Komisioneri vendosi një gjobë.

Përzgjedhja e Fëmijës Bazuar mbi Parapëlqimin Gjinor: Sipas agjencisë statistikore të qeverisë, raporti djem-vajza në lindje në vitin 2017 ishte 109 me 100. Nuk pati përpjekje nga qeveria për të shqyrtuar mungesën e ekuilibrit gjinor.

Fëmijët

Regjistrimi i Lindjes: Individu merr nënshtetësinë me lindjen brenda territorit të vendit ose duke patur njërin prej prindërve nënshtetas. Nuk pati raporte për diskriminim në regjistrimin e lindjes, por kërkesat rënduese për provën e rezidencës dhe banesës për regjistrim e bënë të vështirë atë për shumë prindër romë dhe egjiptiano-ballkanas të cilët nuk kishin dokumentacion ligjor për vendbanimet që të regjistronin fëmijët e tyre.

Fëmijët e lindur nga migrantë të brendshëm, përfshirë disa familje Rome, ose nga ata që janë kthyer nga jashtë shtetit, shpesh nuk kishin certificate lindjeje ose dokumentacion tjetër të ligjshëm lindjeje dhe si rrjedhojë nuk mund të ndiqnin shkollën ose të përfitonin shërbime të tjera.

Arsimi: Ndjekja e shkollës është e detyrueshme deri në klasën e nëntë ose deri në moshën 16 vjeç, cilado vjen e para, por shumë fëmijë, veçanërisht në zona rurale, lanë shkollën më parë për të punuar me familjet e tyre. Prindërit duhet të blejnë mjetet shkollore, librat, uniformat dhe ngrohësit për disa klasa; këto ishin të shtrenjta dhe të pamundura për shumë familje, veçanërisht familjet romë dhe pakica të tjera. Shumë familje gjithashtu përmendën këto kosto për mosdërgimin e vajzave në shkollë.

Qeveria nxorri një vendim përpara nisjes së vitit akademik, sipas të cilit fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e katërt do të merrnin libra falas nëse i kthenin ata në mbarimin e vitit shkollor. Nuk ishte e qartë nëse prindërit do të paguanin gjobë në rast se librat ishin të dëmtuar. Disa OJQ shprehën shqetësim se kjo gjë do të ishte një barrë më e madhe për familjet që merrnin ndihmë sociale, veçanërisht në komunitetin Rom.

Abuzimi me fëmijët: Vëshguesit besonin se abuzimi me fëmijët ishte rritur, sidomos në shkolla. Sipas një sonazhdi kombëtar të mbajtur në 2013, viti i fundit për të cilin ka të dhëna, nga PNUD dhe INSTAT, 57.7 përqind e fëmijëve të anketuar thanë se kanë përjetuar dhunë në një moment të jetës së tyre nga të paktën një anëtar i familjes. Sipas një raporti të 2017 nga World Vision, 70 përqind e fëmijëve në vend raportuan përjetimin e një lloji dhune. Përkufizimi i dhunës në të dy këto anketime përfshinte dhunën psikologjike dhe nuk kufizohej vetëm në dhunë fizike. Shërbimet për viktimat e abuzimit nuk ishin të disponueshme në çast.

Më 23 shtator, komisioneri për të drejtat e njeriut në Këshillin e Europës raportoi shqetësimin e saj për nivelet e larta të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve, përfshirë edhe në ambiente arsimit dhe në shtëpi.

Martesa e Hershme dhe me Detyrim: Megjithëse minimumi i ligjshëm për martesë është 18 vjeç, autoritetet nuk e zbatuan ligjin në çdo rast. Martesat nën moshë ndodhën më së shumti në zonat rurale dhe në bashkësitë rome. Sipas të dhënave të publikuara nga Instituti Shqiptar I Statistikave, numri i martesave të hershme (nën moshën 19 vjeç) në 2017 u ul ndjeshëm nga viti 2016.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Dënimet për shfrytëzimin në tregëti seksi të fëmijëve variojnë nga tetë deri në 15 vjet burg. Vendi ka një ligj që dënon përdhunimin, dhe moshë minimale për marrëdhënie seksuale me dëshirë është 14 vjeç. Dënimi i parashikuar me ligj për përdhunimin është burgim nga pesë deri në 15 vjet. Në rrethana të rënduara, dënimi mund të shkojë në burgim të përjetshëm. Ligji ndalon prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë; dënimet janë burgim nga tre deri në 10 vjet. Zotërimi i pornografisë së fëmijëve është i paligjshëm.

Autoritetet në përgjithësi zbatuan me efikasitet ligjet kundër përdhunimit dhe shfrytëzimit seksual të minoreneve, por OJQ-të raportuan se ligjet që ndalonin pornografinë me fëmijë rrallë u vunë në zbatim. Qeveria raportoi se, deri në korrik, tre fëmijë ishin shfrytëzuar seksualisht, por nuk kishte asnjë rast që përfshinte pornografinë.

Fëmijët e Zhvendosur: Vazhdoi të kishte shumë fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë në rrugë, veçanërisht nga bashkësitë rome. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla. Këta fëmijë ishin më të rrezikuarit nga trafikimi dhe disa prej tyre ranë viktimat e trafikimit. Duke qenë se ligji ndalon procedimin penal të fëmijëve nën moshën 14 vjeç për vjedhje shtëpish, bandit kriminale herë pas here përdornin fëmijët e zhvendosur për të plaçkitur shtëpi.

Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve raportoi se deri në qershor, autoritetet kishin ndihmuar 109 fëmijë të cilët ndodheshin në kushtet e rrugës. 67 prej tyre u venduën pranë strehave. Agjensia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve raportoi 422 raste shfrytëzimi ekonomik të fëmijëve deri në qershor.

Fëmijët në Institucione Përkujdesjeje: Njësia e mbajtjes së fëmijëve migrantë në Karrec u konsiderua nga UNHCR e papërshtatshme për fëmijë dhe familje. Qeveria bëri përpjekje për të shmangur dërgimin e fëmijëve aty, duke i dërguar ata në njësinë e hapur për migrantë në Babrru.

Sipas një raporti të shtatorit nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, rreth 700 fëmijë jetonin në institucione përkujdesjeje publike dhe private, disa prej tyre edhe për periudha të gjata, pa qenë të qartë nëse do mund të largoheshin nga institucionet përpara se të arrinin moshën madhore.

Disa OJQ ngritën shqetësime mbi transparencën e trajtimit të fëmijëve të cilët ishin nën përkujdesjen e institutive shtetërore. Mediat raportuan disa raste të edukatoreve që abuzonin fëmijët në institucione të përkujdesit shtetëror, dhe disa incidente u regjistruan dhe u shfaqen në televizione. Në një rast, një emision lajmesh transmetoi videon e personelit të qendrës në Vlorë teksa abuzonte fëmijët. Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale pushoi nga puna anëtarët e personelit të përfshirë dhe e çoi çështjen në heitm.

Ligji lejon lëvizjen e fëmijëve nga jetimoret në familjet kujdestare, por qeveria dhe bashkitë nuk e kanë përdorur këtë mundësi shumë shpesh.

Vendit i mungonin ndërtesat e përshtatshme për paraburgimin e fëmijëve. Sipas OJQ-së Terre des Hommes, deri në korrik, 17 fëmijë ishin në paraburgim dhe nëntë ishin burgosur.

Rrëmbime Ndërkombëtare të Fëmijëve: Vendi është palë e Konventës së Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimeve Ndërkombëtare të Fëmijëve, e vitit 1980. Shih *Raportin Vjetor për Rrëmbimin Ndërkombëtar Prindëror të Fëmijëve* të Departamentit të Shtetit në adresën: <https://travel.state.gov/content/travel/en/International-Parental-Child-Abduction/for-providers/legal-reports-and-data.html>.

Anti-Semitizmi

Sipas raportimeve, vetëm 40 deri në 50 hebrej jetonin në vend. Nuk pati raportime për akte antisemitike.

Trafikimi i Personave

Shih Raportin për Trafikimin e Personave të Departamentit të Shtetit në adresën: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/

Personat me Paaftësi

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin kundër personave me paaftësi fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore. Megjithatë, punëdhënësit, shkollat, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe ofrues të shërbimeve të tjera shtetërore ndonjëherë kryenin diskriminim. Ligji detyron që ndërtesat e reja publike të jenë të aksesueshme për personat me paaftësi, por qeveria e zbatoi ligjin vetëm në raste sporadike. Përgjatë vitit, qeveria përshtati ndërtesat e 80 qendrave shëndetësore dhe 32 shkollave, si dhe ndërtoi 8 shkolla të reja për të lehtësuar personat me paaftësi.

Qeveria sponsorizoi agjenci të shërbimeve sociale për të mbrojtur të drejtat e personave me paaftësi, por këto agjenci zakonisht kishin mungesa financimi për të vënë në zbatim programet e tyre. Kufizimet në burime dhe mungesa e infrastrukturës e bënë të vështirë që personat me paaftësi të merrnin pjesë plotësisht në çështje civile. Qendrat e votimit shpesh ndodheshin në mjedise që iu mungonin lehtësitë për të tillë persona.

Qeveria hapi dy qendra zhvillimi për personat me paaftësi në Pogradec dhe Bulqizë, mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, si dhe tre kopshte për fëmijë me paaftësi në Pogradec, Sarandë dhe Përmet.

Avokati i Popullit inspektoi institucionet e shëndetit mendor në mënyrë të rregullt. Si pranimi ashtu edhe nxjerrja e pacientëve në institucione të shëndetit mendor ishin problematike për shkak të vlerësimeve të papërshtatshme psikiatrike. Pati diskriminim dhe stigmatizim shoqëror ndaj personave me paaftësi mendore apo të llojeve të tjera.

Pakicat Kombëtare/Racore/Etnike

Pati pretendime për diskriminim ndaj personave të komuniteteve rome dhe egjiptianoballkanike, përfshi në strehim, punësim, kujdes shëndetësor dhe arsim.

Disa shkolla bënin rezistencë për pranimin e nxënësve romë dhe egjiptiano-ballkanikë, sidomos nëse dukeshin të varfër. Shumë shkolla të përziera që praninin nxënës romë i marginalizonin ata në klasa, disa herë duke i veçuar fizikisht nga nxënësit e tjerë.

Bashkia e Tiranës zhvendosi 76 familje rome nga lagjia e Bregut të Lumit në banesa të përhershme në javën e fundit të dhjetorit 2017. Papunësia vazhdoi të ishte një shqetësim dhe rezultoi në pamundësinë e disa prej këtyre familjeve për të paguar faturat e dritave dhe ujit.

Në tetor 2017 qeveria miratoi një ligj të ri për pakicat por Kuvendi nuk miratoi ligjin dhe rregullat zbatuese. Ligji parashikon statusin zyrtar të pakicave për nëntë pakica kombëtare, pa bërë dallime midis grupeve kombëtare dhe etno-gjuhësore. Qeveria përkufizoi grekët, maqedonasit, arumunët (vllehët), romët, egjiptiano-ballkanikët, malazezët, boshnjakët, serbët dhe bullgarët si pakica kombëtare. Ligji i ri parashikon mësim të gjuhës minoritare dhe përdorim zyrtar të dy gjuhëve në njësitë bashkiake ku këto pakica jetojnë kryesisht, ose në ato njësi ku pakicat përbëjnë 20 përqind të popullsisë së përgjithshme. Pakica etnike greke u ankua për mungesën e vullnetit të qeverisë për të njohur komunitete etnike greke jashtë “zonave minoritare” të kohës së komunizmit.

Akte Dhune, Diskriminimi dhe Abuzime të Tjera Bazuar në Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor

Ligji ndalon diskriminimin bazuar në orientimin seksual, përfshi në punësim. Zbatimi i ligjit përgjithësisht ishte i dobët. Në fillim të vitit, Kuvendi amendoi ligjin e strehimit social, duke përfshirë anëtarë të komunitetit lezbik, gei, biseksual, transgjjinor dhe ndërgjinor (LGBTI) si përfitues nga ky ligj. Debatu mbi ligjin në Kuvend u shoqërua me komente homofobike nga disa prej deputetëve. Në 2017 Kuvendi miratoi dy amendime që parashikonin ndihmë ligjore pa pagesë dhe pjesëmarrjen në sporte edhe për komunitetin LGBTI.

Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë ndër grupet e mbrojtura nga ligji i vendit për krimin e urrejtjes. Pavarësisht ligjit dhe mbështetjes formale të qeverisë për të drejtat e personave LGBTI, disa herë zyrtarë publikë bënë deklarata homofobike. Për shembull, një myfti në Librazhd postoi një artikull në një portal në internet, ku kritikoi një OJQ LGBTI që organizonte leksione kundër bulizmit në shkolla të ndryshme, duke e quajtur OJQ-në një “kancer”. Myftiu u kërkoi institucioneve arsimore që të ndalonin hyrjen në shkolla për anëtarët e komunitetit

LGBTI. Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi i dërgoi një letër Komunitetit Islam Shqiptar, duke e nxitur që të ndalte sulme të tilla. Media sociale dhe tradicionale kritikoi fushatën kundër bulizmit, duke akuzuar komunitetin LGBTI se po përpiquej të ndikonte tek të rinjtë në mënyrë të papërshtatshme.

Deir në shtator, Aleanca, një OJQ në mbrojtje të komunitetit LGBTI, dokumentoi 34 raste të dhunës fizike ndaj anëtarëve të komunitetit. Në një rast, policia i kërkoi viktimës, një gruaje transgjnore, të tërhiqte denoncimin; dy javë më pas, dhunuesi e sulmoi atë sërish, duke e çuar në spital. OJQ-ja Streha raportoi se shumë persona LGBTI përjetuan dhunë në familje për shkak të deklaramit të hapur të orientimit të tyre seksual.

Deri në gusht, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori 2 ankesa të cilat pretendonin për diskriminim bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor përgjatë vitit. Komisioni votoi kundër të dyja rasteve.

Stigma Shoqërore ndaj HIV dhe SIDA

Ligji ndalon diskriminimin kundër personave me HIV/SIDA. Shoqata shqiptare e Njerëzve me HIV/SIDA raportoi se diskriminimi dhe stigmatizimi i njerëzve me HIV/SIDA ishte gjerësisht i përhapur në vend.

SEKSIONI 7. TË DREJTAT E PUNËTORËVE

a. Liria e grupimit në shoqata dhe e drejta për marrëveshje kolektive

Ligji dhe rregullore e statute të tjera të lidhura me të sigurojnë të drejtën për pjesën më të madhe të punonjësve të formojnë sindikata, të bëjnë greva të ligjshme dhe të bëjnë marrëveshje kolektive. Ligji ndalon diskriminimin kundërsindikata dhe siguron rikthimin në punë të punonjësve të pushuar për shkak të veprimtarisë në sindikatë.

Ligji ndalon anëtarë të ushtrisë dhe zyrtarë të lartë të qeverisë të bëhen pjesë e sindikatave dhe kërkon që një sindikatë të ketë së paku 20 anëtarë për t'u regjistruar. Ligji garanton të drejtën e grevës për të gjithë punëtorët me përjashtim të personelit të domosdoshëm mjekësor e spitalor, personat që ofrojnë shërbim të kontrollit të trafikut ajror, shërbime në burgje, si dhe zjarrfikësit. Përfshirja në greva ndalohet në "raste të veçanta", si katastrofa natyrore, gjendje lufte, situatë të jashtëzakonshme, dhe raste kur liria e zgjedhjeve është në rrezik. Punonjësit të cilët nuk përjashtohen nga pozicionet e tyre e ushtruan të drejtën e tyre për grevë.

Ligji garantoj mbrojtje të kufizuar ndaj punonjësve shtëpiakë dhe migrantët. Sindikatat e punonjësve ishin kryesisht të dobëta dhe të politizuara. Punonjësit që përfshihen në greva ilegale mund të detyrohen të paguajnë për çdo dëmtim që vjen si pasojë e veprimeve të grevës.

Zbatimi i këtij ligji nga qeveria mbeti gjerësisht jo efektiv, pjesërisht nga përhapja e punësimit informal. Burimet për kryerjen e inspektimeve dhe kompensimin e shkeljeve nuk ishin të mjaftueshme. Gjjobat e larta, të cilat sipas ligjit mund të arrijnë në 1.1 milionë lekë (10,200 dollarë) ose deri në pesëdhjetëfish të pagës minimale mujore, rallë u vlerësuan. Si pasojë, gjjobat nuk ishin pengesë e mjaftueshme për shkeljet. Masat administrative dhe proceduriale iu nënshtruan vonesave të gjata dhe apelimeve. Procedurat e arbitrazhit lejuan vonesa të mëdha të cilat kufizuan mbrojtjen e punonjësve kundrejt veprimtarisë kundër sindikatës.

Punonjësit civilë në të gjitha fushat kanë të drejtën kushtetuese të organizohen dhe të bëjnë marrëveshje kolektive, dhe ligji përcakton procedura për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve për diskutim kolektiv. Sindikatat që përfaqësonin punonjësit e sektorit publik negociuan në mënyrë të drejtpërdrejtë me qeverinë. Marrëveshjet kolektive efikase mbetën të vështira pasi punonjësit shpesh kundërshtuan organizimin dhe aktivitetet e sindikatave. Në këtë mjedis, marrëveshjet kolektive edhe kur arriheshin ishin të vështira për t'u zbatuar.

b. Ndalimi i punës me detyrim

Ligji ndalon të gjitha format e punës së detyruar por qeveria nuk e zbatoi gjithmonë me efikasitet këtë ligj. Mungesa e koordinimit mes ministrave dhe natyra sporadike e zbatimit të procedurave standarde të veprimit vështirësuan zbatimin. Dënimet prej 8 deri në 15 vjet në burg ishin mjaftueshëm të ashpra për të frenuar shkeljet. Organizatat e zbatimit të ligjit trajnuan punonjësit e tyre me një qasje me në qendër viktimat e trafikimit njerëzor. Qeveria vazhdoi të identifikonte viktima trafikimi por ndoqi penalisht dhe dënoi një numër të vogël trafikuesish.

Inspektoriati i Punës nuk raportoi raste të punës së detyruar në sektorin formal përgjatë vitit. Shihni kapitullin 7.c për rastet që përfshijnë fëmijët në punë të detyruar në sektorin informal.

Gjithashtu, shihni Raportin e Trafikimit të Qënive Njerëzore të Departamentit të Shtetit në adresën: www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/

c. Ndalimi i punës së të miturve dhe mosha minimale për punësim

Ligji përcakton moshën minimale të punësimit në 16 vjeç, por lejon fëmijët në moshën 15 vjeç të punësohen në kushte të veçanta kur puna kategorizohet si e “lehtë” dhe nuk pengon shkollën. Në përgjithësi, të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç mund të punojnë në punë të kategorizuara si “të lehta”. Një dekret i vitit 2017 të Këshillit të Ministrave përcaktoi orët e punës për fëmijët më nën 18 vjeç. Fëmijët mund të punojnë deri në 2 orë në ditë dhe deri në 10 orë në javë gjatë vitit akademik, si dhe deri në 6 orë në ditë dhe deri në 30 orë në javë kur shkollat janë të mbyllura. Fëmijët nga 16 deri në 17 vjeç mund të punojnë deri në 6 orë në ditë dhe deri 30 orë në javë nëse puna e tyre është pjesë e arimit të tyre profesional. Sipas ligjit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, nën Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqënies Sociale, është përgjegjës për fuqizimin e kërkesave të moshës minimale nëpërmjet gjykatave, por Inspektorati Shtetëror i Punës nuk e zbatoi si duhet ligjin.

Inspektorët e punës hetuan sektorin e punës formale, ndërkohë që pjesa më e madhe e punës së të miturve kryhej në sektorin informal. Fëmijët i nënshtrohen riciklimit të materialeve metalike dhe plastike, punës në miniera, rrobaqepësisë, nxjerrjes në rrugë, agrikulturës dhe blegtorisë. Fëmijët iu nënshtroan lypjes me detyrim dhe aktiviteteve kriminale. Pati raportime të fëmijëve që punonin si shitës dyqanesh, larës makinash, punëtorë në fabrika tekstilësh ose ilustrues këpucësh. Disa nga fëmijët në rrugë ishin brezi i dytë ose i tretë i lypsarëve. Kërkimet tregojnë se lypja niste që në moshë të vogël, 4 ose 5 vjeç. Ndërsa ligji e ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, policia përgjithësisht nuk e zbatoi atë, megjithëse u bënë përpjekje më të mëdha për ta zbatuar atë përgjatë vitit (Shihni kapitullin 6, Fëmijët e Zhvendosur). Organizata Sociale për Mbështetjen e të Rinjve, një OJQ, raportoi se pjesa më e madhe e fëmijëve në rrugë ishin djem nga 10 deri 17 vjeç. Djemt mblidhnin kryesisht materiale plastike ose metale për riciklim dhe shpesh punonin të pashoqëruar. OJQ-ja World Vision gjithashtu raportoi se fëmijët mblidhnin kanaçe, plastikë dhe metale; si dhe qepnin këpucë. Numri i fëmijëve të përfshirë të aktivitete të rrugës (si lypje apo shitje) u rrit gjatë verës, sidomos në vende turistike.

Inspektorati Shtetëror i Punës nuk kreu kontrole për punën e minorenëve përveçse kur kishte ankesa të caktuara. Pjesa më e madhe e inspektimeve të punës u krye në fabrikat e këpucëve dhe të tekstileve, në call centers dhe në sipërmarrjet me pakicë; zyrtarët gjetën disa raste që përfshinin punë të miturish gjatë inspektimeve të tyre. Dënimet për shkeljet e ligjit rallë u përcaktuan dhe këto nuk ishin të mjaftueshme për të frenuar shkeljet.

Në vitin 2013, viti i fundit kur ka të dhëna, agjencia shtetërore e statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës llogariti 54 000 fëmijë të përfshirë në punë të detyruar në vend. Rreth 43000 fëmijë punonin në ferma dhe peshkim, 4 400 në sektorin e shërbimeve dhe 2200 në hotele dhe restorante. Afërsisht 5 përqind e fëmijëve ishin punonjës të mitur.

Ligji kriminalizon shfrytëzimin e fëmijëve për punë dhe shërbime të detyrurara, por qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin. Vëzhgimi i Inspektorati Shtetëror i Punës për raste të punës së minorenëve si dhe shkelje të tjera të ligjit të punës ishte i pamjaftueshëm.

Sipas Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve, deri në gusht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ekipet e levizshme kishin identifikuar 300 fëmijë në rrugë, pjesa më e madhe e të cilëve kishin marrë shërbimet e përshtatshme. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi raportoi 14 prindër në polici gjatë të njëjtës periudhë.

Shikoni gjithashtu Të Dhënat mbi Format më të Këqija të Punës së të Miturve të Departamentit të Shtetit në faqen: www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose zanatin

Ligjet e punës e ndalojnë diskriminimin në punë për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar fizike dhe mendore, bindjeve politike, kombësisë, besimit fetar, familjes, të jetuarit me virusin e SIDA-s dhe origjinës sociale. Diskriminimi në punësim dhe zanat ndodhi në lidhje me gjininë, aftësitë e kufizuara, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, kombësisë dhe etnisë.

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi raportoi se arsyet kryesore të diskriminimit të pretenduar ishin raca, orientimi seksual, gjendja ekonomike, ose aftësitë e kufizuara.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale kombëtare ishte më e lartë se pragu i varfërisë në nivel kombëtar. Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e pagës minimale por kishte një numër i pamjaftueshëm personeli për të zbatuar këtë detyrim.

Ndonëse ligji përcakton javën 40-orëshe të punës, java aktuale e punës përcaktohet me marrëveshje individuale ose kolektive. Ligji përcakton pushime vjetore të paguara, por vetëm punonjësit në tregun formal të punës kishin të drejta për pushime të paguara. Shumë persona në sektorin privat punuan gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pushime dhe pagesa për punën jashtë orarit por punëdhënësit nuk i zbatuan gjithmonë këto përcaktime. Qeveria nuk kishte standard për numrin minimal të pushimeve në javë dhe rrallë zbatoi ligje që lidheshin me maksimumin e orëve të punës, kufij në punë jashtë orarit, ose pagesë shpërblyese për punë jashtë orarit, veçanërisht në sektorin privat. Këto ligje nuk zbatoheshin për punonjësit në sektorin informal, si për shembull punonjësit shtëpiakë dhe punonjësit migrantë.

Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë profesionale, dhe ndonëse ato ishin të përshtatshme për industrinë kryesore, mungonte në përgjithësi zbatimi. Kushtet e vendit të punës në prodhim, ndërtim dhe sektorin e minierave shpesh ishin të dobëta dhe në disa raste të rrezikshme. Shkeljet e standardeve të sigurisë profesionale ndodhën më shpesh në industrinë tekstile, të këpucëve, ndërtimit dhe minierave. Burimet dhe inspektimet nuk ishin të mjaftueshme dhe dënimet me gjobë shpesh nuk frenuan shkeljet pasi agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kishin mjetet për zbatimin e mbledhjes dhe si rrjedhojë rrallë gjobitën shkelësit.

Punëtorët shpesh nuk mund të dilnin nga situata që rrezikonin shëndetin ose sigurinë e tyre pa rrezikuar punësimin e tyre. Punëdhënësit nuk i mbrojtën efektivisht punonjësit në këto situata.